



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:102529

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05470506

Ac.nr.603/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh. Q. nga P.,U., rruga xxxx, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.A. S. nga F., kundër të paditurve Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Besim Mustafa si dhe I. A. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson Av.V. V. nga P., rruga xxxx, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës së parë të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.252/19, të datës 17.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi** si e themeltë ankesa e të paditurës së parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.252/19 i datës 07.12.2020, pika I dhe II e dispozitivit, që ka të bëjë me aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësit, ndaj të paditurës së parë, për kompensimin e dëmit material në shumën prej 36,000.00 Euro në emër të çmimit të blerjes së banesës dhe shpenzimeve të procedurës dhe tani këto kërkesa gjykohen si në vijim: **REFUZHET** në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses X. Q. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura KGJK që t'ia paguaj shumën prej 36,000.00 Euro në emër të çmimit të blerjes së banesës dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 270.00 Euro.

II. Pika III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.252/19 të datës 07.12.2020, mbetet e pashqyrtuar.

III. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.252/19 të datës 07.12.2020 ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET Pjesërisht** kërkesë padia e paditëses Xh. Q. nga P., si e bazuar. **DETYROHET** e paditura e parë Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës, që paditëses ti a paguajë shumën e përgjithshme prej 36,000.00 euro(tridhjetë e gjashtë mijë euro), në emër të kompensimit të dëmit material, për çmimin e blerjes së banesës, me kamate e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për një vit, nga dita e paraqitjes së padisë, si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 270.00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. **REFUZOHET**, pjesa e kërkesë padisë së paditëses në shumën prej 7.442.74€, të kërkuar në emër të fitimit të humbur, në emër të qirasë së paguar, si e pa bazuar. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesë padia e paditëses kundër të paditurit të dytë I. A., për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura e parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën e të paditurës, ndërsa Aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shqyrtimit dhe analizimit të provave dhe shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), në lidhje me nenin 200 dhe 201, pika b) dhe d) të LPK-së, gjeti se:

#### **Ankesa e të paditurës së parë është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar me datë 04.08.2008 në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurve ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumën prej 36,000.00 Euro në emër të blerjes së banesës.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht për këtë çështje kontestimore ka vendosur me Aktgjykimin C.nr.50/12 të datës 08.04.2014, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe ka detzruar Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor t'ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 43,442.72 Euro, ndërsa është refuzuar kërkesëpadia e paditëses në shumën prej 24,557.26 Euro në emër të fitimit të humbur, është refuzuar kërkesëpadia e paditëses kundër të paditurit I. A. dhe është anuluar kontrata e shitblerjes Vr.nr.806 të datës 16.02.2004.

Sipas ankesës së palëve dnërgjyqëse, Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit Ac.nr.294/14 të datës 19.02.2019, prishë Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.50/12 të datës 08.04.2014 dhe këtë çështje e kthen në rigjykim.

Më pastaj duke vepruar sipas kërkesëpadisë në rigjykim, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave ka vendosur për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, mes tjerash, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se faktet me rëndësi vendimtare për vendosjen e çështjes, gjykata i ka gjetur si vijim: A kanë legjitimitet real pasiv të paditurit për të qenë palë në këtë procedurë dhe rrjedhimisht a kanë përgjegjësi civilo-juridike, për ti'a kompensuar dëmin e pretenduar paditëses? Se i padituri i dytë I. A., a ka pasur për detyrë të bëjë verifikim e origjinalitetit të autorizimit Ov.1993/2004, i datës 22.01.2004, apo vetëm verifikimin e rregullësisë së autorizimit në aspektin se a është prezentuar në këtë autorizim bartja-kalimi i të drejtave nga pronari i banesës B. K., si autorizim-dhënës tek e autorizuar J. V., për shitjen e banesës kontestuese? Faktet tjera, që kishin të bëjnë përkitazi me pagesën e çmimit të banesës sipas kontratës së shitblerjes Vr.nr.806/2004, e datës 16.02.2004 nga paditësja, nuk ishte kontestuese, por pjesa tjetër lidhur me fitimin e humbur për pagesat e qirasë, kthimi i të cilave pretendohet paditësja janë kontestuar në tërësi nga të paditurit. Nuk ishte kontestues fakti se i padituri i dytë ishte punëtor i të paditurës (ish Gjykatës Komunale të Prishtinës) si dhe me datën 16.02.2004, në pozitën e referentit për vërtetimin e kontratave, kishte vërtetuar kontratën Vr.nr.806/2004, të datës 16.02.2004. Në lidhje me faktin nëse i padituri i dytë, se a kishte përgjegjësinë dhe autorizimin si punëtor i të paditurës së parë, për të verifikuar nëse autorizimi kontestues Ov.1993/2004, i datës 22.01.2004, ishte i vërtetuar në mënyrë të rregullt në Gjykatën Komunale të Nishit, R. e Serbisë, gjykata vlerëson se i padituri i dytë, në këtë pjesë nuk ka pasur detyrë dhe as që ka qenë përgjegjës dhe i obliguar të verifikoj saktësinë e origjinalitetit të autorizimit në fjalë. Gjykata gjatë këtij shqyrtimi konstaton se autorizimit në fjalë nuk ka qenë në esencë themeli faktik i padisë së paditëses, jo për shkak se autorizimi kontestues është konfirmuar si i falsifikuar nga Gjykata Themelore e Nishit, me parashtresën me numrin Ov.1993/04, e datës 07.05.2010, por për faktin se pretendimet bazë të padisë konsistojnë në atë se i padituri i dytë **ka pasur apo jo detyrimin-përgjegjësinë zyrtare për të verifikuar identitetin e palëve nënshkruese respektivisht se a ka qenë e autorizuar me autorizim të rregullt J. V.**, përmes së cilës është bërë bartja-kalimi i të drejtave nga ajo tek paditësja, andaj në këtë aspekt nga pretendimet e kërkesëpadisë, gjykata ka vërtetuar se autorizimi Ov.1993/2004, i datës 16.02.2004, ka qenë i pa rregullt sepse me të nuk ka pasur kalim-bartje të drejtave, për shitblerjen e banesës kontestuese nga pronari i saj B. K., tek kinse e autorizuar J. V. dhe rrjedhimisht ajo nuk ka mundur të nënshkruhet si e autorizuar e shitësit-pronarit B. K., në anën tjetër nga autorizimi i tillë shihet se D.D., e ka pranuar për të vetin nënshkrimin në këtë autorizim e cila është paraqitur me numër të njejtë të letërnjoftimit sikurse ai i shënuar më lartë në autorizim kinse nga dhënësi i saj “ Vlastodavac K. B., me nr.224972”, i cili autorizimi nuk është dashur të pranohej si i rregullt, kur e ka paraqitur J. V. si person i autorizuar, për të vepruar në emër dhe llogari të B. K. (pronarit të banesës kontestuese), para së gjithash i njëjti mund të konstatohej me shiqim të lirë dhe lehtësisht mund të vërehet edhe nga krahasimi i thjeshtë i të dhënave nga teksti i vet autorizimit dhe tekstit të kontratës së shitblerjes së datës 16.02.2004. Në autorizimin kontestues në pjesën e vulës vërtetuese të Gjykatës Komunale të Nishit, si dhënës i autorizimit paraqitet personi me emrin D. D., me numër të letërnjoftimit 224972 ndërsa si e autorizuar paraqitet personi me emrin J. V., me numër letërnjoftimi 100249. Në mes të tekstit të autorizimit figuron emri, mbiemri dhe nënshkrimi (i falsifikuar) i pronarit B.

K., me numër të letërnjoftimit 224972, numër i njëjtë me të D. D., në pjesën ku shkruan “Gjykata Komunale në Nish – vërtetohet se D.D., me numër të letërnjoftimit 224972, e pranon për të vetin nënshkrimin e dhënë në këtë dokument të datës 22.01.2004”. Nga vet përshkrimi i nenit (I) të kontratës së shitblerjes së banesës kontestuese ( të cilën e ka pasur në dispozicion i padituri i dytë, së bashku me autorizimin kontestues), pjesa e paraqitjes së palëve kontraktuese, reflekton shpërputhje të hapur, kur në cilësinë e shitësit paraqitet B. K. me numër letërnjoftimi të vërtet **105571**(e që nga autorizim në fjalë ky numër i letërnjoftimit del të jetë i **J. V.**) ndërsa në autorizimin e falsifikuar me numër letërnjoftimi **224972**, andaj nisur nga gjendja e tillë rezulton hapur fakti se autorizimi kontestues ka qenë i pa rregullt me zingjirin e barjtes-kalimit të të drejtave, me qenë se nuk ka prezantuar shitësin-pronarin B. K. si autorizimdhënës andaj gjykata vlerëson se me autorizim Ov,1993/2004 datë 22.01.2004, nuk ka pasur bartje-kalim të të drejtave nga **B. K.** tek **J.V.**, por ka patur bartje të të drejtave nga **D.D.**, tek **J.V.** dhe se identifikimi i faktit se J.V., nuk ka qenë e autorizuar e B. K. por e D. D., **ishte në detyrën e punës së të paditurit të dytë**, mirëpo i njëjti në rastin konkret ka bërë lëshim në kryerjen e punës së tij kur ka lejuar veprimin mashtrues dhe të dëmshëm të J. V., pa qenë e autorizuar të veprojë në përmbylljen e kontratës së shitblerjes Vr.nr.806 e datës 16.02.2004 , në emër dhe llogari të palës shitëse-B.K.. Përkitazi me ekzistimin apo jo të legjitimitetit real pasiv të të paditurve në këtë çështje gjykata vlerëson se e paditura e parë është me legjitimitet pasiv, për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore , në bazë të nenit 172 parg.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978, ligj i aplikueshëm në rastin konkret. Me nenin 172 parg.1 i LMD-së, përcaktohet “Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia ka shkaktuar personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të veta”. Gjykata vlerëson se në rastin konkret e paditura e parë ka përgjegjësi civile ndaj paditëses, për shkak se me veprimin e punëtorit të saj- të paditurit të dytë, i cili duke **ushtruar funksionin zyrtar në vendin e punës** (si referent për vërtetimin e kontratave të shitblerjes së palujtshëmëve) **gjatë orarit të punës dhe në kuadër të detyrave të punës**, ka mundësuar veprimin e paligjshëm të personave të tretë, në dëm të pasurisë së paditëses dhe ky lëshim paraqet veprim të paligjshëm të vet punëtorit të të paditurës së parë. Përgjegjësia e të paditurës së parë është përgjegjësi objektive, e cila qëndron në atë se e paditura e parë ka krijuar lidhjen në mes vetës dhe punëtorit të saj dhe se për punët e caktuara (në rastin konkret vërtetimit të kontratave) ka caktuar punëtorin e saj, të paditurin e dytë si dorën e saj të zgjatur dhe e paditura e parë përgjigjet sikur veprimin e dëmshëm ta kishte shkaktuar vetë. E paditura e parë do të mund të lirohej nga kjo përgjegjësi sikurse të vërtetonte se i padituri i dytë- punëtori i saj, ka vepruar ashtu siç është dashur, gjë të cilën nuk ka arritur ta provon gjatë zhvillimit të kësaj procedure dhe në rastin konkret si shkaktues faktik i dëmit paraqitet nëpunësi shtetëror i padituri i dytë, ndërsa si shkaktues juridik paraqitet institucioni shtetëror – e paditura e parë ( që regruton dhe menaxhon stafin administrativ të gjykatave të Republikës së Kosovës) dhe kjo e fundit është përgjegjëse drejtpërdrejt për dëmet e shkaktuara ndaj paditëses, kjo sepse vlerësimi se është veprimi i punëtorit në rregull apo jo, se a përgjigjet punëdhënësi apo jo, vlerësohet sipas shkallës së përpikëmerisë të cilën punëdhënësi është i obliguar të kryej punët dhe jo sipas shkallës së kujdesit që në rastin konkret kërkohet nga punëtori. Pra autoriteti dhe kredibiliteti i të paditurës së parë (si institucion) që gëzon tek qytetarët për sigurinë e ofrimit të shërbimeve për ata shpreh karshi tyre shkallën më të lartë të besueshmërisë institucionale brenda organeve shtetërore të vendit dhe për lëshimet eventuale në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive institucionale, përgjigjet drejtë për drejt para qytetarëve, ndërsa ekzistimi i moskujdesit të

qëllimshëm i punëtorit të saj është juridikisht relevant vetëm në procedurën e regresimit të punëdhënësit ndaj punëtorit të saj, ndaj dhe për këto arsye i padituri i dytë nuk mund të ketë përgjegjësi civilo-juridike ndaj paditëses por eventualisht vetëm ndaj punëdhënësit të saj respektivisht të paditurës së parë dhe për këtë shkak kërkesë padia e paditëses në drejtim të të paditurit të dytë, është refuzuar për mungesë të legjitimitetit real pasiv të tij në këtë procedurë. Gjykata vlerëson se e paditura e parë, ka detyrim ligjor mbi bazën e nenit 154 lidhur me nenin 170 parg.1 të LMD-së dhe ashtu siç ka përcaktuar dispozita e nenit 155 dhe 185 parg.3 i LMD-së që paditëses të ia kompensoj dëmin material që ia ka shkaktuar me veprim të kundërligjshëm në shumë prej 36,000.00 euro, për shkak të pagesës në emër të shitblerjes së banesës nga jo pronari gjegjësisht personi i paautorizuar për shitjen e saj, nga se e njëjta edhe pse ka paguar çmimin e blerjes nuk ka mundësi që të vazhdojë të jetojë në banesën e “blerë” pa pagesë, fakt ky i cili nuk është konstestues nga të paditurit, se paditësja ka paguar çmimin e tillë. Gjykata ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesë padisë në emër të fitimit të munguar lidhur me kontratën e qirasë të lidhur mes paditëses dhe KPA-në, për shfrytëzimin e banesës në shumën e kërkuar në shqyrtimin e fundit nga paditësja, prej 7,442.74 € nga se paditësi e ka shfrytëzuar banesën për periudhën për të cilën kërkon një kompensim të tillë. Gjykata vlerëson se kontrata e sipër përmendur mbi shitblerjen e kësaj banese nuk prodhon efekt juridik nga se si shitës është personi i cili nuk ka qenë pronar i banesës dhe jo pronari nuk mundet ta tjetërsoj sendin e huaj pa pasur autorizim ligjor nga pronari të nënshkruar nga pronari dhe se askush nuk mund të bart te tjetri më shumë të drejta se që ka vetë nga se me nenin 3 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Themelore Juridike Pronësore është paraparë se te drejtën me disponimin e sendit e ka pronari prandaj kontrata në fjalë është në kundërshtim me rendin kushtetues, dispozitat e detyrueshme gjegjësisht me nenin 3 të ligjit në fjalë dhe është nule në pajtim me nenit 103 të LMD-së, të vitit 1978, e që në rastin konkret ka detyrimin ligjor në bazë të nenit 109 të LMD-së, të kujdeset kryesisht lidhur me vlerësimin e rrethanave dhe kushteve për shpalljen ose jo nule të kontratës së shitblerjes së banesës Vr.nr.806 i datës 16.02.2004, andaj me që në këtë procedurë u provua mjaftueshëm fakti se lidhja e kontratës Vr.nr.806 e datës 16.02.2004, është bërë në kundërshtim me rregullat e detyrueshme ligjore e njëjta duhet të vërtetohet se është nule në bazë të nenit 103 të LMD-së. Gjykata gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka administruar si provë edhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 576/13 i dt. 13.05.2014, ku ka konstatuar se është hudhur padia subsidiare e paditëses, e ushtruar ndaj të paditurit të dytë, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.410/13, të datës 02.02.2015, gjykata ka pushuar hetimet lidhur me akuzën ndaj të akuzuarve J. V. dhe F. Q., ku gjykata administroj edhe prova tjera por të cilat nuk u elaboruan nga fakti se që vlerëson se të njëjtat nuk do të ndikojnë në vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore. Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 277 lidhur me nenin 186 të LMD-së. Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452.1 të LPK-së dhe ka obliguar të paditurën e parë që paditëses ti ja kompensoj shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 270.00€ për përfaqësim në seancë gjyqësore.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me

shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, për pasojë ka pasur edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Si rrjedhojë, Gjykatës se Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, përfshirë këtu Aktvendimin P.nr.576/2013 të datës 13.05.2014, i rezultoi se ndaj të paditurit të dytë I. A. hedhet padia subsidiare e të dëmtuarës në rastin konkret paditëses, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 paragrafi 3 i KPK-ës dhe pushohet procedura penale ndaj të njejtit. Pra sipas kësaj gjykate me këtë provë vërtetohet fakti me rëndësi në rastin konkret dhe vendimtar se i punësuar i të paditurës së parë në kohën e lidhjes së kontratës së shiblerjes në mes të palëve kontraktuese (Vr.nr.806/2004), nuk është shpallur përgjegjës për veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe i autorizimit dhe në rastin konkret me veprimet e të paditurit të dytë nuk është shkaktuar dëmi i pretenduar ndaj paditëses.

Për të ekzistuar baza juridike e kërkesëpadi së paditëses, ndaj KGJK-ës, duhet të vërtetohet veprimet apo mos veprimet e paligjshme të punëtorit të saj, e që në rastin konkret nuk e kemi, për tu plotësuar kushtet ligjore nga nenet 170 dhe 172 të LMD-ës (viti 1978).

Për të ekzistuar dëmi duhet që veprimi apo mos veprimi i të paditurës të jetë rezultat i dëmit të shkaktuar tek paditësja, që në rastin konkret nuk e kemi këtë lidhje shkak-pasojë që është vendimtare në rastin konkret. Ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, është edhe lidhja kauzale që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmtshëm dhe dëmit të shkaktuar, ndërsa në rastin konkret nuk kemi përgjegjësinë e të paditurës së parë dhe punëtorit të saj, për arsye se e njejtja nuk e ka shkaktuar dëmit me lidhjen e kontratës së shitblerjes, nga e cila pretendon paditësja se i është shkaktuar dëmi material.

Pra Gjykata e Apelit vlerëson se për të lindur e drejta e paditëses për të kërkuar kompensimin e dëmit ndaj të paditurës duhet të plotësohet këto kushte ligjore: shkaktimi i dëmit; paligjshmëria e të paditurës (që në rastin konkret mungon); fajësia e të paditurës që ka shkaktuar dëmin (po ashtu nuk ka faj në shaktimin e dëmit të pretenduar) dhe lidhja shkakore në mes të vemprimit, mosveprimit dhe dëmit të shkaktuar, e cila rrethanë në rastin konkret përsëri mungon kjo lidhje, për arsye se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se e paditura apo i punësuar

i saj ka shkaktuar dëmin në shumën prej 36,000.00 Euro, që paditësja këtë shumë në emër të çmimit shiblerës sipas pretendimeve në padi ia ka dhënë J. V. pas lidhjes së kontratës së shitblerjes. Tek rastet e përgjegjësive deliktore si bazë juridike për të kërkuar kompensimin e dëmit duhet të jetë përcaktuar faji i dëmtuesit, e që në rastin konkret me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar faji i të paditurës në shaktimin e dëmit tek paditësja në shumën e pretenduar.

Po ashtu pala ndaj të cilit drejtohet kërkesa duhet të legjitimohet në aspektin pasiv, se cilat kanë qenë veprimet apo mosveprimet e saj, me anë të së cilave i kanë shkaktuar dëm palës paditëse. Pra duhet të vërtetohet lidhje shkakore ndërmjet veprimit apo mosveprimit të të paditurës, çka në rastin konkret nuk e kemi. Gjykata në rastin konkret konstaton se vërtetë të paditurës së parë i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor. Kjo për arsye se legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve të sajuara në bazë të ndonjë raportit juridik-civil, nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin e cënimit të tyre titullari i të drejtës subjektive të cënuar ka të drejtë të kërkon mbrojtje ligjore. Andaj, për këtë arsye dhe duke pasur parasysh faktin se mungesa e legjitimitetit të plotë është e karakterit material-juridik, rezulton se padia dhe kërkesëpasia e paditëses në raport me të paditurën e parë është e pabazuar.

Gjykata sa i përket legjitimitetit pasiv të palës së paditur kujdeset sipas detyrës zyrtare për arsye se është e karakterit material-juridik dhe në rastin konkret e paditura e parë nuk është pjesëmarrëse e raportit juridik nga i cili ka lindur kontesti, pra këtë e përjashton nga përgjegjësia juridike civile sipas dispozitave të LMD-ës, pra nuk plotësohet kushtet e parapara në Kaptina 2 nënpjesa 1.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret, e paditura e parë, përkatësisht punëtori i saj ka vepruar konform kompetencave të tij gjatë vërtetimit të kontratës kontestuese, ndërsa falsifikimi eventual i dokumenteve që duhet të prezentohen gjatë nënshkrimit të kontratës (letërnjoftim, autorizim etj) nuk mund të bien mbi punëtorin e të paditurës, mirëpo ato bien në barrë të atij që ka ndërmarrë veprimin e kundërligjshëm për të prezentuar një dokument të tillë.

Në të gjitha rastet kur vërtetohet nuliteti relativ apo absolut i kontratave, egziston rregulli, i cili konsiston në detyrimin e palëve kontraktuese që të kthejnë njëra-tjetrës krejt atë që kanë marrë sipas bazës së kontratës nule (neni 104 par. 1 të LMD). Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore del se kontrata absolutisht nule në aspektin juridik përfaqëson një zero juridike dhe në qoftë se në përmbushjen e kontratës së tillë është dhënë, duhet të rivendoset gjendja e cila ka qenë para lidhjes së kontratës, sikur një kontratë e tillë të mos kishte ekzistuar fare. Kjo rregull vlen si te nuliteti absolut (neni 104 LMD), ashtu edhe te nuliteti relativ (neni 113 të LMD). Kur kontrata e lidhur ndërmjet palëve kontraktuese (Vr.nr.806/2004 e datës 22.01.2004) shpallet nule, çdonjëra palë është e detyruar të kthejë atë që ka pranuar nga pala tjetër, e në qoftë se për të nuk ka mundësi reale ose juridike, atëherë është e detyruar t'ia shpërblejë vlerën përkatëse.

Në rastin konkret punëtori i KGJK nuk ka pranuar çmimin shitblerës të banesës, ky fakt nuk është kontestues, por çmimin në shumën prej 36,000.00 Euro në emër të çmimit shitblerës e ka pranuar J. V. pas nënshkrimit të kontratës Vr.nr.806/2004 të datës 22.01.2004.

Me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, gjykata e shkallës së dytë ka ardhur në përfundim se me asnjë provë të vetme këtu paditësja nuk e kanë provuar para gjykatës se me veprimet e të paditurës të njejtës i është shkaktuar dëmi. Si rrjedhojë, baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses nuk është provuar dhe arsyetuar fare nga pala paditëse, ndaj të paditurës, përmes provave materiale konkrete, si rezultat i së cilave edhe ka rezultuar se kërkesëpadia e saj është e pathemeltë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, për arsye se është provuar fakti se në rastin e paditëses nuk plotësohen kushtet ligjore nga neni 170 dhe 172 të LMD-ës, për të konstatuar se paditëses me veprimet e paditurës dhe punëtorit të saj i është shaktuar dëmi i pretenduar me lidhjen e kontratës së shitblerjes pranë ish Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Meqenëse nga të cekurat më lartë, ka rezultuar se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e pabazuar në ligj dhe fakte, atëherë gjykata e shkallës së dytë u desht që të ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Pika III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.252/19 të datës 07.12.2020, mbetet e pashqyrtuar bazuar në nenin 194 të LPK-ës, për arsye se asnjë palë ndërgjyqëse nuk ka parashtruar ankesë për këtë pjesë të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitivit III të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 449 të LPK-ës.

Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat e), lidhur me nenin 201 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.603/2021, datë 12.03.2023

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi



Numri i lëndës: 2019:102529  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05470506